



TRANS ADRIATIC

PIPELINE AG,

BAAR

Pasqyrat financiare te mbyllura me

31 Dhjetor 2016 dhe raporti i audituesit ligjor

Mbi shqyrtimin e kufizuar ligjor

Raport i audituesit ligjor mbi shqyrtimin e kufizuar ligjor

Drejtuar Mbledhjes se pergjithshme te

Trans Adriatic Pipeline AG, Baar

Si nje auditues ligjor, ne kemi shqyrtuar pasqyrat financiare (bilancet, deklaratat e te ardhurave dhe shenime) te Trans Adriatic Pipeline AG te mbyllur me 31 Dhjetor 2016.

Keto pasqyra financiare jane pergjegjesi e Bordit te Drejtoreve. Detyra jone eshte qe ne te kryejme nje shqyrtim te kufizuar ligjor mbi keto pasqyra financiare. Ne konfirmojme qe ne i permbushim kerkesat e pavaresise dhe licensimit ashtu sic kerkohet nga ligji Zviceran.

Ne kemi kryer shqyrtimet tona ne perputhje me Standartet e ligjit Zviceran mbi shqyrtimet e kufizuara ligjore. Ky standart kerkon qe ne te planifikojme dhe te zbatojme nje shqyrtim te kufizuar ligjor per te identifikuar gabime materiale ne pasqyrat financiare. Shqyrtimi i kufizuar ligjor perbehet kryesisht nga kerkesat e personelit te shoqerise dhe nga procedurat analitike, si edhe nga testet e detajuara te dokumentave te shoqerise te cilat konsiderohen te nevojshme sipas rrethanave. Sidoqofte, testimi i procedures operacionale dhe i sistemit te brendshem te kontrollit, si edhe hetimet apo procedurat e metejshme te testimit per te zbuluar mashtrime apo dhunime te tjera te ligjit, nuk jane pjese e fushes se ketij ekzaminimi.

Bazuar ne shqyrtimin tone te kufizuar ligjor, nuk kemi gjetur asnje detaj ne pasqyrat financiare e cila vjen ne kundërshtim me legjislacionin Zviceran dhe me Aktin e themelimit te shoqerise.

Deloitte AG

Reinhard Langenhovel
Ekspert i licensuar i auditit
Auditor ne detyre

Martin Lund – Jensen
Ekspert i licensuar i auditit

Zyrih, me 15 Mars 2017
RLA/MLJ/vpf

Shtojca

-pasqyra financiare (bilance, deklarate e te ardhurave dhe shenime)

Pasqyrat financiare
Me 31 dhjetor 2016 (krahasuese me bilancin e 31 dhjetor 2015)

		31.12.2016 ne EUR	31.12.2016 ne CHF	31.12.2015 ne EUR	31.12.2015 ne CHF
Aktive					
AKTIVE AFATSHKURTRA					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	3.1	46,136,428	49,458,251	133,504,677	145,172,985
Llogari te arketueshme	3.2	35,863,271	38,445,427	10,058,466	10,937,576
Shpenzime te parapaguara	5	566,556	607,348	604,719	645,900
Total i aktiveve afatshkurtra		82,566,255	88,511,026	144,167,862	156,756,461
ACTIVE AFATGJATA					
Palujtshmeri, ndertesa dhe paisjeneto	3.3,5	1,535,203,671	1,701,422,250	495,152,825	567,673,307
Te tjera te arketueshme afatgjata	3.2	36,405,208	39,026,383	13,281,280	14,442,064
Depozita dhe para te kufizuara	4.3	4,717,708	5,057,383	4,688,652	5,098,440
Totali i aktiveve afatgjata		1,576,326,587	1,745,506,016	513,122,757	587,213,811
TOTALI I AKTIVEVE		1,658,892,842	1,834,017,042	657,290,619	743,970,272
PASIVI DHE KAPITALI AKSIONAR					
KAPITALI AKTUAL I MARRE HUA					
kreditore	3.4	32,193,856	34,511,814	9,136,702	9,935,250
Detyrimet te tjera afatshkurtra	3.5	1,849,077	1,982,211	756,358	822,464
Shpenzime te maturuara		235,959,476	252,948,558	90,060,680	97,931,983
Totali i kapitalit aktual te marre hua		270,002,409	289,442,583	99,953,740	108,689,697
Kapitali afatgjate i marre hua					
Detyrime te tjera afatgjata		8,859,081	9,496,935	179,679	195,383
Provigjione	3.6	3,453,760	3,702,431	2,443,737	2,657,320
Detyrime te tjera afatgjata me interes	3.7	1,006,968,231	1,179,077,458	388,690,962	439,694,244
Total ii kapitalit afatgjate i marre hua		1,079,281,072	1,192,276,824	391,314,378	442,546,947
Fitime te shtyra nga kursi i kembimit			2,015,675		
KAPITALI AKSIONAR					
kapitali	3.8	480,106,217	553,510,000	304,869,062	361,460,000
humbje te mbartura		(170,496,856)	(203,228,040)	(138,846,561)	(168,726,372)
totali i kapitalit aksionar		309,609,361	350,281,960	166,022,501	192,733,628
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALI AKSIONAR		1,858,892,842	1,834,017,042	657,290,619	743,970,272

**Deklarata e të ardhurave
 per vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 (krahaset për vitin e përfunduar më 31
 dhjetor 2015)**

	shenime	2016 neEUR	2016 neCHF	2015 neEUR	2015 ne CHF
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	3.9	(8,200,631)	(8,939,426)	(19,169,704)	(20,475,161)
Shpenzimet e personelit	3.10	(9,667,055)	(10,537,959)	(12,640,536)	(13,501,357)
Zhvlerësimi i aseteve fikse		(646,881)	(705,158)	(500,725)	(534,824)
Taksat e tjera		(6,261,083)	(6,825,143)	(1,075,971)	(1,149,245)
Shpenzime të tjera		(343,657)	(374,617)	10,088	10,775
Totali i shpenzimeve operative(25,119,307)		(27,382,303)	(33,376,848)	(35,649,812)	
Të ardhura financiare		20,327	22,158	25,029	26,733
Shpenzimet financiare		(7,894,997)	(8,606,257)	(7,633,472)	(8,153,311)
Fitimet e kursit të këmbimit		1,857,785	2,025,152	687,122	733,915
Humbja e përkthimit					(3,987,860)
Humbje vjetore perpara taksave (31,136,192)		(33,941,250)	(40,298,169)	(47,030,335)	
tatimet e drejtpërdrejta		(514,103)	(560,418)	(553,863)	(591,581)
HUMBJE VJETORE		(31,650,295)	(34,501,668)	(40,852,032)	(47,621,916)
HUMBJE TË PËRGJITHSHME NGA FILLIMI I VITIT		(138,846,561)	(168,726,372)	(97,994,529)	(121,104,456)
HUMBJE TË AKUMULUARA FUNDI I VITIT		(170,496,856)	(203,228,040)	(138,846,561)	(168,726,372)

Shenime per Pasqyrat Financiare per vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2016 (krahasuar me vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2015)



1 Informacion i pergjithshem

TransAdriatic PipelineAG(shoqeria) eshte një shoqëri me pergjegjesi te kufizuar e inkorporuar dhe me seli ligjore në Baar, Zvicër me degë në Greqi, Shqipëri dhe Itali.Kompania është e angazhuar në planifikimin, zhvillimin, financimin, ndërtimin dhe operimin e një tubacioni dhe infrastrukturës ngjitur për transportin e gazit natyror nga rajoni i Kaspikut në tregun evropian ("Projekti"). Me 28qershor 2013,Kompania u zgjodh nga Konsortiumi Shah Deniz si projekti i tubacionit të preferuar për transportin e gazit natyror nga fusha e Shah Deniz II në Azerbajxhan për në Evropë.Tubacioni rreth 870 km i gjatë do të lidhet me tubacionin Trans Anatolian pranë kufirit turko-grek në Kipoi dhe do të kalojë neper Greqi, Shqipëri dhe ne Detin Adriatik, përpara se të perfundoje në Italinë Jugore.

Aksionet e saj përbëhen nga:

	31.12.2016		31.12.2015
•AxpoTradingAG		5%	5%
•SNAMS.pA		20%	20%
•BPGasMarketingLimited		20%	20%
•AZTAPGmbH		20%	20%
•FluxysEuropeB.V.		19%	19%
•EnagasInternationaI.S.L.U.		16%	16%

Kapitali aksionar i kompanisë është 553,510,000 franga dhe përbëhet nga 553,510,000 aksione të zakonshme me vlerë nominale CHI- 1,00 për aksion.

Ne vitin 2016dhe ne vitin2015mesatarja vjetore e punësimit me orar të plotë nuk tejkalonte 250 pozicione.

2 Principet kryesore të kontabilitetit dhe vlerësimit

Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat Financiare të Kompanisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2016 janë përgatitur në përputhje me ligjin e ri të Zvicrës për raportimin financiar.

Për shkak të faktit se Shoqëria nuk i tejkalon kriteret për ndërmarrjet më të mëdha siç parashihet në Nenin 727 të Kodit Zvicerian per Detyrimeve (CO) për dy vite të njëpasnjëshme, kompania nuk ka detyrim me ligj që të ketë një auditim të zakonshëm, prandaj nuk është i detyruar të përgatisë një grup të gjerë të pasqyrave financiare në përputhje me nenin 961 te (CO). Keto pasqyra financiare përbëhen nga bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shënimet.

Përmbledhje e kontabilitetit kryesor dhe parimet e vlerësimit

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, të cilat nuk janë të specifikuar nga Kodi i Detyrimeve, janë paraqitur më poshtë.Këto politika janë zbatuar per llogaritë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016.

Monedhat e huaja

Llogaritje dheValuta e Prezantimit

Njesite e perfshira ne pasqyrat financiare jane matur duke përdorur monedhën e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon Kompania.Për shkak të faktit se shumica e kostove të kompanisë janë kryer në EURO, kjo konsiderohet të jetë monedha kontabël e aktiviteve të saj të biznesit.

Trans Adriatic Pipeline AG – pasqyrat financiare per vitin ushtrimor më 31 dhjetor 2016

Transaksionet dhe Bilancet

Transaksionet në valutë të huaj përkthehen në monedhën e kontabilitetit në njohjen fillestare duke përdorur kurset e këmbimit që mbizotërojnë në datën e transaksionit ose vlerësimit ku zërat janë ri-matur. Fitimet dhe humbjet valutore që rrjedhin nga shlyerja ose nga përkthimi i mjeteve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedha të huaja në fund të periudhës raportuese, njihen në pasqyrën e të ardhurave. Mjetet jo monetare të matura në terma të kostos historike në një monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Përkthimet

Për qëllimet statutoare pasqyrat financiare paraqiten në Franga Zvicerane. Përkthimi u krye duke zbatuar një metodë të modifikuar të tanishme / jo-aktuale:

- Aktivet dhe detyrimet rrjedhëse janë përkthyer me kursin aktual të këmbimit në datën e bilancit të gjendjes;
- Bilancet jo-monetare të aktiveve afatgjatë janë përkthyer me kursin e këmbimit historik;
- Bilancet monetare të aktiveve afatgjatë janë përkthyer në nivelin më të ulët të kursit të këmbimit historik ose aktual në datën e bilancit;
- Bilancet monetare të detyrimeve afatgjata janë përkthyer në nivelin më të lartë të kursit të këmbimit historik ose aktual në datën e bilancit;
- Ekuivalenti është përkthyer me kursin e këmbimit historik;
- Pasqyra e të ardhurave janë përkthyer me kursin mesatar vjetor të këmbimit.

Diferencat e kursit të këmbimit nga përkthimi regjistrohen si në vijim:

Humbjet e përkthimit regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave;

Fitimet e përkthimit janë shtyre dhe janë regjistruar si provizione në pasqyrat financiare.

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 janë aplikuar kurset e mëposhtme të këmbimit:

Kursi i këmbimit aktual 1.072CHF/EUR

Norma mesatare vjetore e këmbimit 1.090CHF/EUR

Paratë dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë e gatshme, paratë e gatshme në llogaritë rrjedhëse bankare brenda dhe jashtë vendit dhe depozitat afatshkurtra me maturim deri në tre muaj.

Bilancet e kufizuara përjashtohen nga paratë e gatshme dhe ekuivalentët e tyre. Bilancet e kufizuara nga shkëmbimi ose përdorimi për të shlyer detyrimin për më shumë se dymbëdhjetë muaj pas paraqitjes së të dhënave të bilancit janë të paraqitura në aktivet afatgjata.

Paratë e gatshme, depozitat bankare në bankë dhe depozitat afatshkurtra vlerësohen me vlerën nominale (nominale).

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga:

- Të arkëtueshme nga sigurimet dhe organizatat e sigurimeve shoqërore
- Taksat në lidhje me personelin
- Taksat dhe interesat të lidhura me taksat (përveç taksave mi të ardhurat p.sh. TVSH)
- Te tjera të arkëtueshme afatshkurtra

Prona, Impiante dhe Pajisje

Prona, Impiante dhe pajisje (PIP) janë artikuj të prekshëm të cilët janë të disponueshëm për përdorim në prodhim dhe furnizim të mallrave ose shërbimeve, për qëllime qiraje ose administrative, dhe që pritet të përdoren për më shumë se një periudhë.

Njohja dhe Matja

Pronat, impiantet dhe pajisjet janë deklaruar me kosto, me me pak zhvleresim të akumuluar ose/dhe humbje si pasojë e zhvleresimit. Humbja si pasojë e zhvleresimit është shuma me të cilën vlera bartese (d.m.th vlera neto) tejkalon shumën e rikuperrueshme. Kosto e një prone, impianti apo pajisje përfshin:

- (a) cmimin e blerjes (vlera e zbritjeve tregtare dhe reduksioneve), përfshirë këtu detyrimet e importit dhe taksat e pakthyesmetë blerjes
- (b) çdo kosto e cila i atribuohet në mënyrë direkte sjelljes së aseteve në vendodhje në kondicionet e nevojshme për të operuar në mënyrën e kërkuar nga menaxhuesit
- (c) një vlerësim paraprak i kostove të montimit dhe largimit të atikullit e restaurimit të zones në të cilën ndodhet, nëse i tillë është rasti.

Trans Adriatic Pipeline AG – pasqyrat financiare per vitin ushtrimor me 31dhjetor 2016

Kostot e asetete te vete-ndertuara perfshijne kostot e materialeve, e punes direkte dhe pjesen e duhur te shpenzimeve te prodhimit.

Kostot e mevoneshme

Kostoja e zevendesimit te pjese te artikullit te prones, objektit ose pajisjeve njihet ne vleren kontabel te artikullit, nese eshte e mundur qe perfitimet e ardhshme ekonomike te kesaj pjese do te derdhen ne kompani dhe kostot e saj mund te maten me besueshmëri. Shpenzimet e sherbimit të përditshëm të pronës dhe pajisjeve njihen në fitimin ose humbjen si të ndodhura. Kjo do të thotë që shpenzimet e sherbimit të përditshëm të një artikulli të PIP (p.sh. mirëmbajtja e riparimeve) nuk do të njihen në vlerën kontabel të një artikulli të PIP-së, por do të shpenzohen në periudhën në të cilën ato janë kryer.

Shvleresimi

Për secilin aset në kategorine e pronës (përveç tokës/truallit), impianteve dhe pajisjeve, shvleresimi i ngarkohet deklarates se fitimit dhe humbjes duke përdorur metodën e vijës së drejtë gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të asetit. Zhvlerësimi i një aseti fillon kur është në dispozicion për përdorim, d.m.th. nga dita e parë e muajit që pason muajin kur aseti ndodhet në vendin dhe gjendjen e nevojshme për shfrytëzim në mënyrën e synuar nga menaxhmenti. Si pasoje, ndodh nje zhvlerësim konstant i jetëgjatësisë së dobishme të asetit. Metodatat e zhvlerësimit rishikohen në çdo datë të mbylljes.

	Jetëgjatësia e përdorimit(vite)
Mobilje per zyra	5-10
Pajisje per zyra	10-15
ITHardware	3-5

Asetet në ndërtim:

Gjatë fazës së zhvillimit dhe ndërtimit, kostot e lidhura me zhvillimin dhe ndërtimin e tubacionit kapitalizohen dhe klasifikohen si "Pasuritë në Ndërtim" brenda pronës, impiantit dhe pajisjes. Këto përfshijnë kostot e materialit, punën e drejtpërdrejtë dhe një pjesë të përshtatshmet e shpenzimeve të prodhimit, si dhe kostot për furnizimet dhe shërbimet e kontraktuara që kanë ndodhur në fazën e zhvillimit dhe ndërtimit. Sapo tubacioni të përfundojë dhe të porositet, "Pasuritë në Ndërtim" do të transferohen në kategorinë e duhur të aseteteve kohe nga e cila do të fillojnë shvleresimi i jetëgjatësisë së dobishme bazuar ne normen e shvlerësimit se kategorise perkatese,

Komponentët e mëposhtëm të tubacionit janë identifikuar dhe jetëgjatësia e përdorimit (periudha e ardhshme e shvlerësimit) të komponentëve është vlerësuar paraprakisht:

	Parashikimi i jetëgjatësisë se përdorimit e (vite)
Tubacioni dhe pajisjet ndihmese perkatese	25
Stacionet e kompresoreve	25
Trualli	jo e shvlerësuar
Shkarkimin	25
Ngrenia e tokes	25
Kostos e kapitalizuara te huamarrjes dhe artikuj te tjere	25

Kostot e Huamarrjes

Kostot e huamarrjes përbëhen nga interesat dhe shpenzimet e tjera që një njësi ekonomike ka në lidhje me huamarrjen e fondeve.

Kostot e huamarrjes që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, ndërtimit ose prodhimit të një aseti që domosdoshmërisht merr një periudhë të konsiderueshme kohore për t'u përgatitur për përdorimin e synuar, kapitalizohen si pjesë e kostos së aseteteve perkatëse.

Gjatë fazes se zhvillimit, kostot e huazimit të shpenzimeve të depozitimit të borxhit kompensohen përmes fitimit dhe humbjes.

Kreditorët e tregtisë dhe detyrimet e tjera

Kreditorët e tregtisë janë detyrime që rrjedhin nga blerja e transaksioneve që lidhen me aktivitetet kryesore të biznesit të njësisë ekonomike. Detyrimet që rrjedhin nga shpërndarjet dhe shërbimet e marra nga palët e ndërlidhura raportohen gjithashtu nën këtë titull. Kreditorët e tregtisë paguhesh nga Kompania si rezultat i kontratave ku pala tjetër ka dorëzuar tashmë mallra ose shërbime të kryera dhe ka lëshuar një faturë, por kompania akoma nuk ka kryer pagesën për të cilën është rënë dakord.

Kreditorët e tregtisë njihen kur është e mundur që një transaksion në formën e daljes së burimeve ekonomike kërkohet për të shlyer detyrimin dhe shuma e shlyerjes mund të matet me besueshmëri.

Detyrimet e tjera janë detyrime që rrjedhin nga transaksionet që nuk janë dërgesa të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet kryesore të biznesit të kompanisë ose aktivitetet e financimit.

Të gjithë llogarite e pagueshmet të cilat nuk bien në ndonjë kategori tjetër paraqiten këtu, p.sh.

- Llogarite e pagueshmendaj sigurimeve dhe organizatave shoqërore
- Borxhet e lidhura me personelin (p.sh. pushimet dhe detyrimet jashtë orarit)
- Tatimet dhe interesa tatimore (p.sh. TVSH, tatimet në burim)
- Detyrime të tjera afatshkurtra
- Pagesa të ndryshme

Detyrimet e tjera njihen kur është e mundur që një dalje e burimeve ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe shuma e shlyerjes mund të matet me besueshmëri.

Provigjone

Provigjonet njihen kur kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet nga shuma e detyrimit. Kur kompania pret që një pjese ose i gjithë provigjoni të rimburohet, për shembull, në bazë të një kontrate sigurimi, rimbursimi njihet si një aset i veçantë, por vetëm kur rimbursimi është praktikisht i sigurt. Shpenzimi që lidhet me cilëndo provigjon paraqitet në pasqyrën e të ardhurave neto pa ndonjë rimbursim.

Nëse efekti i vlerës kohore të parasë është material, provigjonet zbriten duke përdorur një normë aktuale para-tatimore që reflekton, kur është e përshtatshme, rreziqet specifike të detyrimit. Kur përdoret skontimi, rritja në provigjon për shkak të kalimit të kohës njihet si një shpenzim financiar.

Detyrimet e kushtëzuara janë detyrime të mundshme, ekzistenca e të cilave do të konfirmohet vetëm nga ngjarje të ardhshme që nuk janë tërësisht nën kontrollin e grupit, ose nga obligime të pranishme kur nuk është e mundur të kërkohet një dalje e burimeve- ose shuma e detyrimit nuk mund të matet me besueshmëri e mjaftueshme. Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare, por janë të shpalosura në shënimet, përveç rasteve kur mundësia e një daljeje të burimeve ekonomike konsiderohet e largët.

Dhënia me qira

Një kontratë qiraje është një marrëveshje sipas së cilës qiradhënësi i percjell qiramarrësit, në këmbim të një pagese ose seri pagesash, të drejtën për të përdorur një aset për një periudhë të caktuar. kohe.

Qiramarrja klasifikohet si një qera financiare nëse transferon në menyre thelbesore të gjitha rreziqet dhe përfitimet që ndodhin gjatë pronësisë.

Qiratë në të cilat një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë nuk transferohen në kompani si qiramarrës klasifikohen si qira operationale. Pagesat e bëra sipas qirasë operative (pa ndonjë stimul të marrë nga qiradhënësi) ngarkohen në fitim ose humbje në bazë të linjës së drejtë gjatë periudhës së qirasë.

Kompania nuk ka pasur ndonjë qera financiare në vitin 2016.

Tatimet

Tatimi i të ardhura përfaqëson shumën e tatimit që aktualisht paguhet.

Tatimi i të Ardhurave Aktuale

Pasuritë dhe detyrimet e tatimit mbi fitimin maten në shumën që pritet t'iu paguhet autoriteteve tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore të përdorura për të llogaritur shumat janë ato që miratohen ose miratohen në mënyrë të konsiderueshme në datën e raportimit në vendet ku vepron kompania.

Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabiliteti

Përgatitja e pasqyrave financiare të kompanisë kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumën e raportuara të shpenzimeve, asetëve dhe detyrimeve, si dhe shpalosjen e detyrimeve kontingjentë. Pasiguritë në lidhje me këto supozime dhe vlerësime mund të pasojë në rezultate që kërkojnë përshtatje materiale në vlerën kontabël të aktiveve ose detyrimeve të ardhshme.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në përvojën e menaxhmentit dhe në faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmerite për ngjarjet e ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekur. Në veçanti, informacionet për fushat e rëndësishme të vlerësimit, pasigurisë dhe gjykimit kritik në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë:

- Asetet në ndërtim e sipër - Kostot e Zhvillimit të Kapitalizuar dhe të Ndërtimit
- Taksat direkte
- Provigjonet

Kapitalizimi i kostos

Kostot e Zhvillimit dhe Ndërtimit

Kompania kapitalizon kostot e zhvillimit dhe të ndërtimit për projektin në përputhje me politikën kontabël. Kapitalizimi fillestar i kostove bazohet në gjykimin e menaxhmentit që konfirmon realizueshmërinë teknologjike dhe ekonomike. Në përcaktimin e shumave që do të kapitalizohen, menaxhimi bën supozime lidhur me shume e parave që do të gjenerojë projekti, normat e skontimit që do të aplikohen dhe periudhën e parashikuar të përfitimeve.

Faza e Zhvillimit

Faza e zhvillimit përfshin të gjitha detyrat perkatëse të planifikimit dhe inxhinierisë për të mbështetur the final investment decision (FI), ESIA (Environmental and Social Impact Assessment), FEED (Front End Engineering Design), Permitting, HGA (Host Governmental Agreement) negotiations, LEA (Land easement and acquisition) and GTA (Gas Transportation agreement). Kompania ka përfunduar studimin e fizibilitetit për projektin në mars të vitit 2006. Në vitin 2008 kompania hyri në fazën fillestare të projektit, faza e Projektimit të Inxhinierisë (FEED), dhe filloi të kapitalizojë shpenzimet që lidhen me Projektin. Shpenzimet e kapitalizuara përfshijnë kosto teknike, ligjore dhe shpenzimet të cilat mund të lidhen direkt me tubacionin. Në mars 2013 kompania përfundoi FEED.

Konsorciumi Shah Deniz, përzgjedhi kompaninë si rrugë e preferuar të transportit për gazin Kaspik në Evropë më 28 qershor 2013. Në nëntor 2013 aksionerët e kompanisë miratuan Rezolutën për Konstruksion dhe në dhjetor 2013, Konsorciumi Shah Deniz mori Vendimin Përfundimtar të Investimit në Shah Deniz Projektin në fazën II.

Në vitin 2014, Leja për Zhvillim të Përbashkët - Faza 1, për Shoqërinë u miratua nga Këshilli Kombëtar Shqiptar i Territorit (KKT), i cili autorizoi Kompaninë të fillojë aktivitetet e saj të ndërtimit në Shqipëri. Në vitin 2014, qeveritë greke dhe italiane miratuan Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis. Procesi i prokurimit për të gjitha kontratat kryesore u ekzekutua dhe u përfundua gjatë 2015 dhe 2016.

Faza e zhvillimit zgjati deri në Dhenien e Kontrates Finale, e cila u zhvillua në fund të tremujorit të parë të 2016.

Faza e Ndërtimit

Faza e ndërtimit filloi në vitin 2015 me punën përgatitore para-ndërtimore për infrastrukturën shqiptare. Puna kryesore e ndërtimit filloi në tremujorin e parë të vitit 2016 dhe do të zgjasë deri në FG (First Gas) në vitin 2020. Ajo përfshin detyra të tilla si ndërtimi i infrastrukturës, stacionet e kompresorëve, tubacioni në tokë dhe në det, si dhe shkarkimi, dhe aktivitetet të drejtuara.

Spektori i kompanisë, është plotësisht i përafruar me zhvillimet në rrjedhën e sipërme. Zhvilluesit e tubacionit filluan ndërtimin në fillim të 2016: Konsorciumi Shah Deniz planifikon shitjet e para të gazit në Gjeorgji dhe Turqi për fundin e vitit 2018; Dërgesat e para në Evropë do të pasojnë përafërsisht një vit më vonë.

Megjithatë, Projekti është i rrezikuar nga disa ndryshime që mund të ndodhin me kalimin e kohës. Këto përfshijnë risqe të lejuara, politike ose teknike, të cilat mund të çojnë në vonesa në orarin e Projektit ose tejkalimin e kostos, gjë që mund të rezultojë në konkludimin nga aksionerët se Projekti është bërë i paarritshëm. Në një situatë të tillë, aksionerët mund të zgjedhin të mbyllin Kompaninë. Rrjedhimisht, mund të kërkohej shlyerje e kostove të kapitalizuara dhe Kompania mund të futet në borxhe.

Megjithatë, risqet monitorohen vazhdimisht nga menaxhmenti dhe aksionarët. Përveç kësaj, vlerësimi i risqeve është zyrtarisht i shqyrtuar çdo vit nga Bordi i Drejtorëve. Deri më 31 Dhjetor 2010, Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti i Kompanisë nuk presin dhe nuk janë në dijeni për ndonjë pengesë të madhe për Projektin dhe parashikojnë se kostot e kapitalizuara përfaqësojnë përfitime të ardhshme ekonomike për Shoqërinë.

Tatimet

Ekzistojnë paqartësi në lidhje me interpretimin e rregullave komplekse tatimore, ndryshimet në ligjet tatimore, si dhe sasinë dhe kohën e të ardhurave të ardhshme të tatueshme. Duke pasur parasysh përcaktimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të biznesit dhe natyrën afatgjatë dhe kompleksitetin e marrëveshjeve kontraktuale ekzistuese, mund të lindin dallime ndërmjet rezultateve aktuale dhe supozimeve të bëra ose ndryshime të ardhshme në këto supozime mund të kërkojnë përshtatje të ardhshme të shpenzimeve të regjistruara. Dallime të tilla të interpretimit mund të lindin në një larmi çështjesh në varesi nga kushtet që mbizotërojnë në Kompani dhe deget e saj.

Provigjonet

Aktualisht Kompania është subjekt i disa sfidave ligjore në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social në vendet e operacioneve. Provigjoni për shpenzimet që lidhen me procedurat ligjore është vlerësuar në bazë të informacionit më të mirë në dispozicion që nga data e bilancit të fletës. Ekzistojnë paqartësi rreth kohëzgjatjes dhe vleres së levizjeve monetare.

3 Informacion në lidhje me artikujt e bilancit dhe pasqyren e të ardhurave

3.1 Parate dhe ekuivalentet e saj

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2015
Para në dore	6,576	7,050	10,072	10,951
Para në banke	46,129,852	49,451,201	33,494,605	36,422,034
Depozita afatshkurtra bankare			100,000,000	108,740,000
Totali	46,136,428	49,458,251	133,504,677	145,172,985

3.2 Llogaritë e arketueshme

	31 Dhjetor 2016 Ne EURO	31 Dhjetor 2016 Ne CHF	31 Dhjetor 2015 Ne EURO	31 Dhjetor 2015 Ne CHF
TVSH dhe taksa të tjera	72,055,360	77,243,345	23,206,091	25,234,303
Te arketueshme të tjera	213,119	228,465	133,655	145,337
Totali	72,268,479	77,471,810	23,339,746	25,379,640
Pjese jo-aktuale	36,405,208	39,026,383	13,281,280	14,442,064
Pjese aktuale	35,863,271	38,445,427	10,058,466	10,937,576

3.3 Prone, Impiant dhe Pajisje

	31 Dhjetor 2016 Ne EURO	31 Dhjetor 2016 Ne CHF	31 Dhjetor 2015 Ne EURO	31 Dhjetor 2015 Ne CHF
Regjistrimet dhe pajisjet	5,392,969	6,309,307	5,392,969	6,309,307
Trualli dhe te drejtat e truallit	112,787,397	122,634,243	14,286,583	15,259,499
Asetet ne ndertim	1,419,996,539	1,575,918,113	477,799,626	548,838,756
Me pak shvleresim	(2,973,234)	(3,439,413)	(2,326,353)	(2,734,255)
Totall	1,535,203,671	1,701,422,250	495,152,825	567,673,307

3.4 Kreditoret e tregtise

	31 Dhjetor 2016 Ne EUR	31 Dhjetor 2016 Ne CHF	31 Dhjetor 2015 Ne EURO	31 Dhjetor 2015 Ne CHF
Per t'iu paguar paleve te treta	32,043,952	34,351,116	9,021,837	9,810,346
Per t'iu paguar paleve te aferta	149,904	160,698	114,865	124,904
Totall	32,193,856	34,511,814	9,136,702	9,935,250

3.5 Detyrime te tjera te momentit

	31 Dhjetor 2016 ne.EURO	31 Dhjetor 2016 Ne CHF	31 Dhjetor 2015 Ne EURO	31 Dhjetor 2015 Ne CHF
Detyrime ndaj sigurimeve shoqerore	187,248	200,731	69,214	75,264
Detyrime ndaj fondit te pensioneve...	196,858	211,031	174,053	189,265
Detyrime ndaj autoriteteve te tatimeve	1,464,971	1,570,449	356,884	388,076
Detyrime ndaj paleve te tjera te treta			156,207	169,859
Totall	1,849,077	1,982,211	756,358	822,464

3.6 Provigjonet

	31 Dhjetor 2016 neEUR	31 Dhjetor 2016 neCHF	31 Dhjetor 2015 neEUR	31 Dhjetor 2015 neCHF
Provigjonet per ceshtje gjyqesore	2,500,000	2,680,001	2,443,737	2,657,320
Provigjone per nxjerre nga perdorimi Detyrime	58,416	62,622		
Provigjone per fitimet e parealizuara te kursit te kembimit	895,344	959,808		
Totall	3,453,760	3,702,431	2,443,737	2,657,320

3.7 Detyrimet afatgjata te interest

	Norma e interest ne %	Maturimi	31 Dhjetor 2016 Ne EUR	31 Dhjetor 2016 Ne CHF	31 Dhjetor 2015 Ne EUR	31 Dhjetor 2015 Ne CHF
Hua nga aksioneret	FTA+ 1%	30 Korrik 2043	1,006,968,231	1,179,077,458	388,690,962	439,694,244
Totall			1,006,968,231	1,179,077,458	388,690,962	439,694,244



3.8 Kapitali aksioanar

	Numri i aksioneve te zakonshme te paguara dhe te detyruara	Shuma ne CHF mije	Shuma ne EUR mije
Balanca ne 1 Janar 2014	174,260,000	174,260	143,835
Leshimi i aksioneve te zakonshme gjate vitit	100,000,000	100,000	81,533
Balanca ne 31 Dhjetor 2014	274,260,000	274,260	225,369
Leshimi i aksioneve te zakonshme gjate vitit	87,200,000	87,200	79,500
Balanca ne 31 Dhjetor 2015	361,460,000	361,460	304,869
Leshimi i aksioneve te zakonshme gjate vitit	192,050,000	192,050	175,237
Balanca ne 31 Dhjetor 2016	553,510,000	553,510	480,106

Ne 26 Nentor 2015 shoqeria leshoi 87,200,000 aksione te zakonshme plotesisht te paguara me nje vlere nominale 1.00 Franga Zviceriane secila.

Ne 29 Korrik dhe 27 Tetor 2016 Kompania leshoi perkatesisht 143,000,000 dhe 49,050,000 aksione te zakonshme plotesisht te paguara me nje vlere nominale prej 1.00 Franga Zviceriane secila.

3.9 Shpenzime te pergjithshme dhe administrative

	2016 Ne EUR	2016 Ne CHF	2015 Ne EUR	2015 Ne CHF
Tarifat e sherbimit te konsulences dhe keshillimit	3,491,913	3,806,499	9,083,798	9,702,405
Mirembajtje IT, konsultim dhe suport	604,973	659,475	3,507,401	3,746,255
Travel and accommodation	698,115	761,009	1,318,377	1,408,158
Shpenzime te tjera te pergjithshme dhe administrative	165,771	180,705	1,146,415	1,224,486
Shpenzimet e marredhenieve me publikun dhe marketingut	2,727,017	2,972,694	2,445,201	2,611,719
Zyra dhe sherbimet	136,134	148,399	633,101	676,215
Komunikimi	51,992	56,676	228,065	243,596
Sigurimi	300,291	327,344	135,001	144,195
Te tjera	24,425	26,625	672,345	718,132
Totali	8,200,631	8,939,426	19,169,704	20,475,161

3.10 Shpenzimet e personelit

	2016 neEUR	2016 neCHF	2015 ne EUR	2015 neCHF
Paga, shperblime dhe komisione,	7,239,217	7,891,398	8,125,226	8,678,671
Shpenzimet e detyrueshme te sigurimeve shoqerore	971,801	1,059,350	851,794	909,801
Pune me kontrate	13,068	14,245	1,312,882	1,402,289
Kostot e pensioneve	629,935	686,686	686,626	733,385
Kosto te tjera te personelit	813,034	886,280	1,663,898	1,777,209
Totali	9,667,055	10,537,959	12,640,536	13,501,355

4 Informacion shtese

4.1 Detyrimet e Lizingut

Kompania jep me qira zyra te ndryshme, pajisje zyre dhe infrastrukturë IT sipas marrëveshjeve të qirasë operative. Shpenzimet e qirasë kompensohen në fitim dhe humbje gjatë vitit. Kushtet minimale të qirasë për marrëveshjet e qirasë që nuk mund të anulohen janë ndërmjet 3 dhe 5 vjet dhe shumica e marrëveshjeve të qirasë janë të rinovueshme në fund të periudhës së qirasë në kushtet e tregut.

Trans Adriatic Pipeline AG – pasqyrat financiare per vitin ushtrimor me 31 dhjetor 2016

Kompania është e detyruar të njoftojë 3 deri 6 muaj paraprakisht për ndërprerjen e këtyre marrëveshjeve. Pagesat minimale të agreguara të qirasë së qirave të ardhshme të cilat nuk do të skadojnë dhe nuk mund të ndërpriten brenda dymbëdhjetë muajve të ardhshëm, i nënshtrohen strukturës së mëposhtme të pagesave:

	31 Dhjetor 2016 Ne mijera EUR	31 Dhjetor 2016 ne mijera CHF	31 Dhjetor 2015 ne mijera EUR	31 Dhjetor 2015 ne mijera CHF
Jo me shume se san je vit	2,954	3,167	955	1,020
Me shume se nje vit por me pak se 5 vite	2,022	2,168	2,738	2,924
Me shume se sa 5 vjet			33	35
Totali	4,976	5,335	3,726	3,979

Kompania gjithashtu jep me qera disa ambiente zyrash nen qira te anulleshme. Periudha e njoftimit per keto marreveshje varjon nga 1 deri ne 6 muaj.

Shpenzimet e qirasë të ngarkuara në fitim dhe humbje gjatë vitit janë në shumën 133 euro (145 franga) mijëra (2015: 633 EUR (676 CHF) mijëra).

4.2 Angazhimet Tregtare

Në lidhje me ndërtimin e tubacioneve, kompania ka hyrë në disa marrëveshje për blerjen e materialeve, pajisjeve dhe shërbimeve përkatëse të inxhinierisë dhe ndërtimit që arrijnë në vlerën 1.6 miliardë euro më 31 dhjetor 2016 (me 31 dhjetor 2015 në vlerën 1.2 miliardë euro).

4.3 Kontigjencat tregtare

Kompania ka premtuar depozitën e saj bankare për një shumë totale prej rreth 4.5 milionë euro si kolateral për garancinë bankare në favor të një prej aksionerëve të saj.

4.4 Kontigjencat ligjore

Aktualisht Kompania është subjekt i disa sfidave ligjore në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social në Greqi dhe Itali. Këto sfida mund të çojnë në vonesa të projektit derisa të ngrihet një apel i suksesshëm ose të gjenden zgjidhje alternative.

Gjatë aktiviteteve normale, Shoqëria mund të përfshihet në procedura ligjore, pretendime dhe procese gjyqësore me palë të treta. Bazuar në informatat e disponueshme në kohën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare përveç atyre të përmendura më sipër, nuk ka fakte apo indikacione të tjera për ngjarjet e ardhshme të cilat mund të kenë efekt material negativ në gjendjen financiare të Kompanisë, në rezultatet e operacioneve ose flukset e levizjeve monetare.

5 Informacion krahasues

Parapagimet e bëra për blerje mallrash dhe shërbimesh që lidhen me tubacionin në ndërtim janë të përfshira në vlerën e "Pasurive në ndërtim". Përshkrimi i shifrave të vitit paraprak u radhit në përputhje me rrethanat për të arritur një përfaqësim të qëndrueshëm me vitin aktual.

6 Ngjarjet pas datës së perfundimit te bilancit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të mëvonshme pas datës së raportimit që kërkon rregullime ose dhënie informacionesh shpjeguese për këto pasqyra financiare.

Ambriela Sulaj
12/12




TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, BAAR

*Financial Statements for the year ended
31 December, 2016 and Report of the
Statutory Auditor on the Limited
Statutory examination*



Report of the statutory auditor on the limited statutory examination

To the General Meeting of
Trans Adriatic Pipeline AG, Baar


As statutory auditor, we have examined the financial statements (balance sheet, income statement and notes) of Trans Adriatic Pipeline AG for the year ended 31 December, 2016.

These financial statements are the responsibility of the Board of Directors. Our responsibility is to perform a limited statutory examination on these financial statements. We confirm that we meet the licensing and independence requirements as stipulated by Swiss law.

We conducted our examination in accordance with the Swiss Standard on the Limited Statutory Examination. This standard requires that we plan and perform a limited statutory examination to identify material misstatements in the financial statements. A limited statutory examination consists primarily of inquiries of company personnel and analytical procedures as well as detailed tests of company documents as considered necessary in the circumstances. However, the testing of operational processes and the internal control system, as well as inquiries and further testing procedures to detect fraud or other legal violations, are not within the scope of this examination.

Based on our limited statutory examination, nothing has come to our attention that causes us to believe that the financial statements do not comply with Swiss law and the company's articles of incorporation.

Deloitte AG



Reinhard Langenhövel
Licensed Audit Expert
Auditor in Charge



Martin Lund-Jensen
Licensed Audit Expert

Zurich, 15 March, 2017
RLA/MLJ/vpf

Enclosures

- Financial statements (balance sheet, income statement and notes)

Balance Sheet
as at 31 December 2016 (comparatives as at 31 December 2015)

